

Universiteti i Prishtinës

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183

Fax: +381-38-244187

URL: <http://ee.uni-pr.edu>

Mail: rektorati@uni-pr.edu

Rektori
Enver Hasani
enver.hasani@uni-pr.edu

Ref. nr. 1/136

Prishtinë 7.5.2007

Në bazë të nenit 49 pika 8 e të Statutit të Universitetit të Prishtinës Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.4.2007, miratoi këtë

Rregullore mbi studimet e doktoratës në UP

Neni 1

Me këtë Rregullore organizohet programi i studimeve të doktoratës sipas sistemit të Bolonjës dhe standardeve të tjera evropiane mbi arsimin e lartë (më tej shkurt: studimet e doktoratës) në UP nga shtatori i vitit 2008.

Studimet e doktoratës kanë karakter hulumtues shkencor dhe paraqesin një projekt personal dhe profesional të definuar qart sa i përket qëllimit si dhe mënyrës së realizimit të tij në një disiplinë të caktuar. Ato mund të kenë edhe karakter multidisiplinar.

Studimet e doktoratës organizohen përmes planeve dhe programeve të studimit të cilat miratohen nga Senati i UP-së, jo më larg se 12 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje

Neni 2

Planet dhe programet nga paragrafi 2 të nenit 1 të kësaj Rregullore i nënshtrohen sistemit të kredive ECTS dhe ruajnë raportin 60 me 40 përqind në mes të teorisë dhe praktikës (hulumtimit/eksperimentit).

Neni 3

Në secilën njësi akademike caktohet udhëheqësi i programit të doktorates (në tekstin e më tej: udhëheqësi).

Udhëheqësi nga paragrafi i mësipërm duhet të jetë me thirrje të profesorit të rregullt, ose të plotësojë kushtet nga neni 27, paragrafi 3 pika e Statutit të UP-së, pa marrë parasyshë thirrjen akademike,

Kompensimin mujor për udhëheqësin nga paragrafi i mësipërm e cakton Këshilli Drejtues i UP-së sipas propozimit të Rektorit.



Neni 4

Këshilli Qendror për Studimet e Doktoratës në UP (më tej shkurt: Këshilli), i cili themelohet nga Senati sipas propozimit të Rektorit, bën miratimin e listës përfundimtare të udhëheqësve nëpër njësitë akademike.

Këshilli përbëhet nga :

- Rektori dhe Prorektori për Mësim dhe kerkime shkencore;
- Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (më tej shkurt : ASHAK);
- Një profesor i rregullt, ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmi i shkencave shoqrore;
- Një profesor i rregullt ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmi i shkencave teknike;
- Një profesor i rregullt, ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmi i arteve;
- Një profesor i rregullt, ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmia e shkencave matematiko- natyrore;
- Një profesor i rregullt, ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmi i mjekësisë;
- Një profesor i rregullt, ose një profesor tjetër që plotëson kushtet nga neni 27 par. 3 pika a e Statutit, pa marrë parasyshë titullin, nga lëmia e shkencave të bujqësisë dhe vetërinës;

Koordinatori i përgjithshëm i Sistemit Evropian të Transferit të Krediteve (ECTS)- pa të drejtë vote.

Neni 5

Këshilli nga paragrafi i pikës së mësipërme kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregullore dhe për të njëjtën i raporton Senatit të UP-së.

Mandati i Këshillit zgjatë 3 vjet, dhe përfundon me vetë programin e studimeve të doktoratës

Neni 6

Studimet e doktoratës zgjasin 3 vjet dhe fillojnë pas çdo përfundimi të programit trevjeçar, kurse numri i studentëve nuk mund të jetë më i lartë se tre për departament/katedër. Për studentët që kanë mbaruar magjistraturë shkencore, studimet zgjasin 2 vite (magjistratura do t'i ekuivalentohet me sistemin e kredive deri 1/3 e numrit të përgjithshëm të kredive të parapara).

Përgjatë paragrafi i mësipërm, njësitë akademike mund të propozojnë rritjen e numrit, sidomos për gjeneratën e parë nëse këtë e kërkojnë:

- nevojat e ngritjes së kuadrit që punon në njësinë akademike përpaktëse e cila kërkon rritjen e numrit nga paragrafi 1 i nenit 6 të Rregullores (asistentët);
- nevojat e angazhimit në ndonjë projekt hulumtues/shkencor ose eksperimental brenda, apo jashtë UP-së, në rastet kur ky angazhim mund të



Universiteti i Prishtinës

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

përdoret si projekt bazë për pjesën hulumtuese-shkencore ose eksperimentale të programit të doktoratës;

- nevojat e tregut vendor të dijes, në rastet kur këto nevoja mund të provohen me statistika e fakte të besueshme;

Propozimi i tillë për rritjen e numrit të studentëve në studimet e doktoratës duhet të prezantohet në Senat, me arsyetim të detajuar, nga ana e dekanit të njësië akademike përkatëse.

Neni 7

Pranimi i studentëve në studime të doktoratës bëhet përmes konkursit publik, i cili duhet të shpallet në gazetën ditore.

Të drejtë regjistrimi në studimet e doktoratës kanë kandidatët që kanë mbaruar master sipas sistemit të Bolonjës si dhe kandidatët që kanë mbaruar magjistraturë shkencore.

Me rastin e pranimit të studentëve në studimet e doktoratës duhet të merren parasysh këto kushte:

- nota mesatare gjatë studimeve master, si dhe kohëzgjatja e studimeve
- publikimet shkencore- artistike;
- njohja e gjuhëve të huaja.

Kalimi i studentëve nga një lëmi në tjetrën në studimet e doktoratës nuk lejohet.

Neni 8

Mbrojtja e disertacionit të doktoratës bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 133-137 të Statutit të UP-së, vetëm pasi kandidati të ketë dhënë provimet, përfunduar hulumtimet, pjesën eksperimentale dhe me këtë ka siguruar kreditë e mjaftueshme ECTS, ashtu siç parashihet me nenin 2 të kësaj Rregullore, si dhe pasi të ketë botuar së paku një punim me recension ndërkombëtar nga lëmia në të cilën studion në kuadër të programit të doktoratës.

Neni 9

Doktoratat e lejuara nëpër njësitë akademike para hyrjes në fuqi të Statutit të UP-së, por që nuk janë mbrojtur deri më 31 gusht 2006 si dhe temat e lejuara nga njësitë akademike, pas hyrjes në fuqi të Statutit të UP-së në bazë të rregulloreve të vjetra duhet të sillen për miratim në Senat. Mbrojtja e këtyre temave nuk mund të bëhet pa u miratuar në Senat ashtu sikundër nuk mund të bëhet brenda një harku kohor më të shkurtër se dy vjet nga data e lejimit në njësitë akademike, por jo më vonë se 31.12.2008

Përfundim nga paragrafi i mësipërm bëjnë rastet e doktoratave të cilat kanë kaluar të gjitha instancat e kërkuara me Statut dhe rregulloret e vjetra të njësive akademike dhe presin mbrojtjen publike. Në raste të tilla do të zbatohen dispozitat përkatëse të Statutit të UP-së mbi ratifikimin e tyre në Senat.

Neni 10

Me qëllim të sigurimit të kontrollit të cilësisë së studimeve doktorale të filluara në disa njësi akademike e që janë në proces zbatohet procedura e vazhdimit të punës së këtyre programeve nëpër njësitë akademike si në vijim:



A / - para se të mbrohet doktoratura kandidati duhet të plotësojë këto kritere:
të botojë së paku një punim shkencor nga lëmi i hulumtuar në një revistë ndërkombëtare.

- për kandidatët që kanë kaluar procedurën e vlerësimit të temës dhe të kandidatit, duhet të organizohet një prezentim publik në të cilin do të dëshmohet me transparencë të plotë, progresi i arritur. Në këtë prezentim duhet të marrë pjesë mentorin, mundësisht edhe anëtarët e tjerë të komisionit për vlerësim, kurse është e obligueshme të ftohet anëtari i Këshillit Qendror për studime të doktoratës nga lëmi përkatës, i cili do të raportojë për progresin e kandidatit.
- Mentorët kandidatët e të cilëve nuk kanë përparuar në disertacionin e doktoratës nuk mund të marrin në mbikëqyrje akademike kandidatë të tjerë derisa të mos përfundojnë me sukses brenda afatit të caktuar kandidatit përkatës.
- Temat të cilat nuk përfundojnë brenda afatit prej 6 viteve duhet të rifillojnë procedurë të re.

B / - Njësitë akademike mund të vazhdojnë punën me kandidatët që i kanë pranuar në studimet e doktoratës pa kaluar vlerësimin e temës dhe të kandidatit me kushtet në vijim:

- Kandidatët duhet të akumulojnë së paku 30 kredi (ECTS) nga lëndet të cilat kanë për qëllim t'i përgatisin ata për kërkime shkencore në fushën e doktoratës përkatëse si në vijim:
Metodologji e kërkimit shkencor – 9 ECTS,
Shkathtësitë e mësimin akademik- 7 ECTS, dhe
Aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) – 7 ECTS;
Projekt aplikativ nga lëmi i ngushtë profesional – 7 ECTS
- 30 ECTS tjera fitohen nga punimet seminarike të cilat kanë potencial të botohen në revista shkencore;
- Kandidati duhet të prezentojë publikisht projektin kërkimor para njësisë akademike në të cilën do të vërtetohet se ai është aftësuar për punë kërkimore- shkencore të pavarur.
- Në këtë prezentim duhet të ftohet anëtari i Këshillit Qendror të Studimit të doktoratës nga lëmi përkatës, i cili do të jetë në cilësinë e referuesit.

Neni 11

Për rastet e doktoratave të parashikuara në nenin 9 vlejnë edhe këto rregulla shtesë:

- mentorin, bashkmentorin nga një universitet tjetër që e ka udhëhequr kandidatit deri në fazën e vlerësimit të disertacionit të doktoraturës, nuk mund të jetë anëtar komisioni për mbrojtje publike të disertacionit. Kandidati së bashku me mentorin (bashkmentorin) bëjnë mbrojtjen publike të disertacionit para komisionit.
- Komisioni për mbrojtje publike të disertacionit të doktoratës përbëhet prej 3 - 5 anëtarëve;
- Dy,përkatësish 3 anëtar të komisionit për mbrojtje publike duhet të jenë nga lëmia e ngushtë nga e cila kandidati ka marrë doktoratën ;

Neni 12

Dekani i njësisë akademike duhet të prezantojë me gojë e me shkrim në Senat , me rastin e ratifikimit, të dhënat për disertacionin, kandidatit dhe komisionin para të cilit



Universiteti i Prishtinës
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINENSIS

synohet të bëhet mbrojtja, duke ofruar dëshmi të mjaftueshme për biografinë dhe përgaditjen profesionale të anëtarëve të komisionit për mbrojtjen publike të doktoratës.

Neni 13

Disertacionin e hartuar të doktoratës, kandidati ia paraqet Fakultetit në 15 ekzemplarë.

Administrata e Fakultetit ka për detyrë të shpallë kohën dhe vendin e mbrojtjes sipas mënyrës së zakonshme dhe me anën e shtypit të përditshëm, së paku 7 ditë para ditës së mbrojtjes.

Neni 14

Mbrojtja fillon me atë që kryetari i komisionit i njofton të pranishmit me biografinë dhe mbi punimet e tij shkencore, e pastaj kandidati, me një shpjegim të lirë, paraqet në formë koncize problemet që i ka përfshirë në punimin e vet, metodën që e ka zbatuar dhe rezultatet që i ka arritur.

Në procedurën e mëtejme të mbrojtjes anëtarët e komisionit i bëjnë pyetje kandidati dhe kërkojnë nga ai shpjegime, madje me atë radhë të cilën e cakton kryetari.

Pasi të jetë kryer diskutimi, komisioni tërhiqet që të marrë vendim.

Kandidati e ka mbrojtur disertacionin e doktoratës po qe se shumica e anëtarëve të komisionit i vlerëson pozitivisht përgjigjet dhe shpjegimet e tij.

Komisioni mund të vendosë njëzëri se kandidati e ka mbrojtur disertacionin e doktoratës me sukses të shkëlqyeshëm.

Mbrojtja përfundon me kumtimin publik të rezultatit të vlerësimit.

Për mbrojtjen përpilohet një procesverbal i shkurtër, të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit dhe që i dërgohet dekanit.

Dekani e njofton rektorin e Universitetit mbi disertacionin e mbrojtur të doktoratës për shkak të promocionit.

Personi që mbron me sukses disertacionin e doktoratës, fiton të drejtën të marrë diplomën doktor i shkencave të degës shkencore përkatëse, përkatësisht doktor i degës përkatëse.


Diploma e doktoratës së shkencave, përkatësisht diploma e doktoratës së degës përkatëse i dorëzohet me rastin e shpalljes publike e solemne (promocionit për doktor shkencash). Promocionin e bën dhe diplomën e dorëzon rektori i Universitetit sipas dispozitave të Statutit.

Neni 15

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përcaktuar me këtë Rregullore vlejnë dispozitat e Statutit të UP-së dhe dispozitat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë.

Neni 16

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit të Prishtinës.


Rektori
Prof. Asc. Enver Hasani



Universiteti i Prishtinës

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-244183
Fax: +381-38-244187

URL: <http://www.uni-pr.edu>
Mail: rektorati@uni-pr.edu

Rektori
Enver Hasani

Ref. nr. 1/545

Prishtinë, 19 6 2008

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.6.2008, miratoi këtë

**Aneksrregullore mbi nryshimin e rregullores mbi studimet e doktoratës në UP
nr. 10/136 të datës 7.5.2007**

Neni 1

Neni 10, pika B/1, ndryshohet dhe bëhet kështu:
Kandidatët duhet të akumulojnë së paku 30 kredi (ECTS) nga lëndët të cilat kanë për qëllim
t'përgatisin ata për kërkime shkencore në fushën e doktoratës përkatëse si në vijim:
Metodologjia e kërkimeve shkencore 10 ECTS,
Shkathtësitë e shkrimit akademike 10 ECTS dhe
Aplikimi i teknologjisë së informacionit në kërkime shkencore 10 ECTS.

Neni 1/a

Te pika B/1 e nenit 10 - Lënda e katërt mësimore "Projekti aplikativ nga lëmi i ngushtë
profesional – 7 ECTS" zëvendësohet me këtë tekst:
Prezantimi publik i projektit aplikativ nga lëmi i ngushtë profesional, përkatësisht paraqitja e
projektpropozimit të tezës shkencore të miratuar 30 ECTS si aline e re.

Neni 2

Ky ndryshim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Snati i Universitetit të Prishtinës dhe është
pjesë përbërëse e Rregullores mbi studimet e doktoratës nr. 1/136 të datës 7.5.2007

